VENDIM
Nr. 26/2014

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E AKUZAVE MBI IMPLIKIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA DHE BAZAVE USHTARAKE NË VEPRIMTARI TË KUNDËRLIGJSHME - TRANSPORTIN E LËNDËVE NARKOTIKE

(Ndryshuar me vendimin nr. 28, datë 8.5.2014; nr. 37/2024, datë 29.5.2014)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor parlamentar me objekt të veprimtarisë së tij: Hetimin dhe zbardhjen e plotë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, lidhur me akuzat e bëra publike për implikim të Forcave të Armatosura dhe bazave të saj ushtarake në veprimtari të kundërligjshme në transportin e lëndëve narkotike.

II. Komisioni ka për qëllim zbardhjen e së vërtetës mbi akuzat e bëra publike dhe nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, rregullimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës.

III. Komisioni hetimor përbëhet nga 9 anëtarë: 5 anëtarë nga shumica parlamentare dhe 4 anëtarë nga opozita. Kryetari i komisionit i takon grupit të deputetëve nismëtarë.

IV. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1. Ermonela Felaj PS
2. Arben Çuko PS
3. Pirro Lutaj PS
4. Anduel Xhindi PS
5. Silva Caka LSI
6. Oerd Bylykbashi PD
7. Gent Strazimiri PD
8. Voltana Ademi PD
9. Alban Zeneli PDIU.
10. Ermonela FelajKryetare PS
11. Oerd Bylykbashi Zëvendëskryetar PD

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 1-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 24.4.2014